

**ANA LALAJ: PRANVERA E RREJSHME  
E PESËDHJETEGJASHTËS, Shtëpia botuese: Infbotues,  
Tiranë 2015, 322 faqe**

Historia e Konferencës III të Komitetit të PPSH-së për Tiranën (më tej: Konferenca e Tiranës), në prill 1956, është një prej atyre ngjarjeve, të cilën udhëheqja komuniste shqiptare do të kishte dëshirë ta injoronte. Por, ndërsa tekstet shkollore gjatë regjimit komunist refuzonin ta përmendnin këtë ngjarje, dhe ajo nxirrej nga arkivat vetëm kur ndihej ndonjëri prej delegatëve “rebelë”, opinionin publik nën zë vazhdonte të ngrinte pyetje dhe të diskutonte rreth saj. Pas rënies së regjimit komunist, Konferenca e Tiranës natyrshëm ngjalli interesin e opinionit publik dhe studiuesve. Pjesëmarrës në ngjarje, analistë e gazetarë kanë shkruar jo pak rreth kësaj konference, por deri vonë mungonte një qasje shkencore ndaj saj. Libri i prof. dr. Ana Lalaj, “Pranvera e rrejtshme e ‘56” plotëson këtë boshllëk, pasi sjell një punim të mirëfilltë shkencor mbi këtë ngjarje, të bazuar në burime të shumta historike dhe në një literaturë impresionuese.

Thelbi i narrativës së punimit është përpjekja për një lloj liberalizimi të regjimit komunist në Lindjen Komuniste, e nxitur kjo nga ndryshimet politike të ndodhura në Bashkimin Sovjetik menjëherë pas vdekjes së Stalinit më 1953. Prof. Lalaj e ka mbështetur analizën e saj në katër shtylla kryesore:

Fillimisht ajo na sjell një panoramë të detajuar të situatës së brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë përgjatë viteve '50, duke e kontekstualizuar kështu Konferencën e Tiranës. Në një analizë të mbështetur fort në fakte, statistika dhe dokumente, autorja na sjell vështirësitë e shumta ekonomike të Shqipërisë në fillim të viteve '50. Propagandës së PPSH-së për zhvillimin e vrullshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit, punimi i vendos përballë një sërë dokumentesh shqiptare dhe sovjetike, të cilat hedhin dritë mbi politikën e gabuara ekonomike të ndjekura nga Tirana zyrtare, si: investimet e pamjaftueshme dhe politikën e gabuara tatimore për fshatin shqiptar; niveli i ulët i jetesës së shqiptarëve dhe nevoja për ta përmirësuar atë; shpenzimet shumë të larta për forcat e armatosura dhe nevoja për të shkurtuar numrin e tyre etj.

Ndër faktorët e jashtëm që luajtën rol të rëndësishëm në zhvillimet politike në Shqipërinë e viteve '50, autorja me të drejtë përcakton ndryshimet që ndodhën në Bashkimin Sovjetik pas vdekjes së Stalinit. Ardhja e Hrushovit në krye të PK të BS solli tronditje në Bllokun Komunist. Tezat e tij për bashkekzistencën paqësore ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit ridimensionuan politikën ndërkombëtare. Ndërsa raporti sekret i mbajtur nga Hrushovi, në të cilin denoncoheshin krimet e Stalinit dhe nxitej dënimi i kultit të tij, shkaktoi

furtunë në lidhshpirtin komunist të Bllokut Lindor. Me të drejtë në punim nënvizohet se fryma liberalizuese në politikën ekonomike dhe sociale, angazhimi i Hrushovit për të rikthyer në Bllokun Komunist Jugosllavinë e Titos, të larguar më 1948-ën dhe, veçanërisht, rehabilitimi i disa drejtuesve të lartë evropianolindorë, të dënuar si pasojë e thyerjes Stalin-Tito, sollin një tjetër frymëmarrje brenda Bllokut. Në disa raste, si në Varshavë dhe në Budapest, kjo frymë e re nxiti lëvizje qytetare, të cilat formuluan kërkesa që preknin madje dhe thelbin e sistemit politik. Në Tiranë shkaktoi shqetësim dhe dilema të vështira për drejtuesit komunistë shqiptarë. Ata e kishin mbështetur legjitimitetin e regjimit mbi “qëndrimin e drejtë dhe parimor” që kishin mbajtur ndaj Jugosllavisë së Titos dhe agjentëve të tij vendas, një nga emrat më të spikatur ndër të cilët ishte ish-ministri i Brendshëm dhe sekretari organizativ i KQ të PPSH, Koçi Xoxe. Riafrimi me Jugosllavinë apo rehabilitimi i Koçi Xoxes konsiderohej i pamundur për Enver Hoxhën dhe drejtuesit e lartë komunistë, pasi kjo në mënyrë të paevitueshme do të thoshte rrezikim i pushtetit të tyre. Prof. Lalaj ka shpjeguar në mënyrë të detajuar dhe realizëm prej profesionisteje qëndrimin e Koçi Xoxes ndaj Jugosllavisë dhe marrëdhëniet e tij me Enver Hoxhën.

Shtylla e dytë e punimit mbështetet mbi arsyet se përse komunistët e Tiranës vendosën të ngrinin zërin në një konferencë të zakonshme partie. Duke shfletuar librin arrin të futesh në atmosferën e kohës dhe të kuptosh se si, ditë pas dite, klima politike në Shqipëri ngarkohej sa me pakënaqësitë për drejtimin jo të duhur të vendit, aq edhe me revoltën e njerëzve për hendekun që sa vinte dhe thellohej midis njerëzve të thjeshtë dhe drejtuesve të lartë komunistë. “Blloku i udhëheqjes” nuk ishte vetëm një lagje e izoluar dhe e padepërtueshme në qendër të Tiranës, por një oazë privilegjesh në paga, ushqime, mallra konsumi, shërbim shëndetësor etj. Hendeku mes drejtuesve të një vendi që propagandonin barazi natyrshëm do të shkaktonte pakënaqësi, e cila ushqehej edhe nga sinjalet që vinin nga Moska për më shumë demokraci në parti e për reflektim ndaj së shkuarës. Ishin pikërisht këto pakënaqësi të mbarsura me kohë që gjetën rrugën për të shpërthyer në Konferencën e Tiranës.

Analiza e ditëve të Konferencës dhe kthesës së fuqishme që mori situata gjatë zhvillimit të saj përbën një tjetër bosht të punimit. Në një narrativë ku gërshetohen faktet e ftohta, të nxjerra nga dokumentet e shumta të vjela nga një sërë arkivash shqiptarë dhe të huaj, me një analizë sa historike aq edhe të natyrës njerëzore, autorja sjell evoluimin e ngjarjeve përgjatë konferencës, duke na krijuar kështu mundësinë të njohim nga afër anatominë e dhunës dhe të represionit të regjimit komunist ndaj qytetarëve të tij. Metamorfoza e Enver Hoxhës nga një njeri i mirëkuptueshëm, i arsyeshëm, gati-gati atëror, në një drejtues arrogant që sulmon, akuzon, heton, jep verdikte është sjellë me një realizëm të dhimbshëm. Sipas prof. Lalaj, qëllimi i Enver Hoxhës, me sjelljen e tij aq brutale gjatë ditëve të konferencës, ishte t’i kalonte muret e saj. Më

shumë se një mesazh për delegatët që guxuan të kundërshtonin, qëndrimi i tij ishte një paralajmërim për të gjithë të tjerët. Me realizëm të dhimbshëm sillet gjithashtu në punim dhe transformimi që pësuan delegatët “rebelë” të Konferencës, të cilët guxuan të ngrinin zërin përballë padrejtësive të përditshme, por u thyen nga forca dhe pesha e pushtetit autoritar.

Analiza e qëllimeve të kundërshtimit të delegatëve të Konferencës së Tiranës zë një vend të posaçëm në analizën e prof. Lalaj. Delegatët e Konferencës, në një masë dërrmuese intelektualë, ishin komunistë idealistë, të cilët kishin kontribuar në forma e mënyra të ndryshme për vendosjen dhe forcimin e regjimit. Të gjithë ata, edhe atëherë, edhe më pas, kanë pohuar se nuk kërkonin rrëzimin e regjimit. Këtë pohon me vërtetësi edhe autorja, por, më shumë se kaq, ajo na ka sjellë një qasje metodologjike e teorike. Ajo shpjegon se në mënyrë të qëllimshme regjimi kishte krijuar një koncept fluid dhe kundërtënës mbi kritikët dhe kundërshtarët. Duke i mbivendosur këto koncepte, regjimi mbyste kritikën, dogmatikisht të pranuar, pasi të gjithë ata që ngrinin zërin për të kundërshtuar udhëheqjen, konsideroheshin kundërshtarë të regjimit. Edhe në rastin e delegatëve kritikë ndaj udhëheqjes komuniste u zbatua e njëjta strategji. Prof. Lalaj bën përcaktimin e duhur të këtyre delegatëve duke i konsideruar ata kritikë ndaj politikave të caktuara të ndërmarra, por jo kundërshtarë të regjimit. Duke bërë këtë ajo i jep Konferencës peshën e saj reale në historinë e Shqipërisë.

Analiza e pasojave të Konferencës së Tiranës, si për aktorët kryesorë të saj, ashtu dhe për shoqërinë shqiptare, është shtylla e fundit, por përbën thelbin e gjithë punimit. Konferenca e Tiranës pati pasoja të rënda për të gjithë ata që guxuan t’u thoshin drejtuesve të regjimit të vërtetat e pamohueshme, jo si kundërshtarë që kërkonin rrëzimin e tij, por për ta sjellë atë afër idealeve që ata kishin ushqyer. Por më shumë se pasojat personale, rrjedha e ngjarjeve përgjatë Konferencës vrau shpresën për ndryshime qoftë edhe në kuadër të regjimit.

Në kuadër të kuptimit të anatomisë së dhunës, duhet të shihet dhe në punim analiza që i bën autorja ndikimit të faktorëve të jashtëm në ngjarjet e Konferencës së Tiranës. Në diskursin politik dhe shkencor gjatë viteve të komunizmit, jugosllavët janë fajësuar si organizues të Konferencës. Ky qëndrim ka mbizotëruar dhe në historiografinë e pas viteve ’90. Për prof. Lalajn nuk ka dokumente as jugosllave, as shqiptare që ta mbështesin këtë tezë. Në një analizë bindëse që u bën ajo personazheve të akuzuar për bashkëpunim me jugosllavët, të fajësuar, madje të dënuar si organizatorë të Konferencës së Tiranës, përmendim këtu Tuk Jakovën, Bedri Spahiun, Liri Gegën, Dhora Lekën etj., lexuesi ngre dyshimin e arsyeshëm mbi çfarë është shkruar në historiografinë e deritanishme mbi këtë çështje. Duke mohuar çdo ndërhyrje nga jashtë në organizimin e Konferencës, autorja Lalaj shkon dhe më tej. Ajo konkludon se “konferenca kishte frymë, por jo organizim”, duke përcaktuar kështu edhe arsyet e mospjesëmërisë së saj.

Thuhet se një punim shkencor është i arrirë kur ia del të prekë mendjet, të nxisë mendimet, të ngrejë dyshime mbi njohuritë e deritanishme. Libri i prof. Ana Lalaj, “Pranvera e rrejshme e ‘56” ngacmon jo vetëm mendjen, po dhe shpirtin e lexuesit. Falë punës së saj kërkimore në një sërë arkivash shqiptarë dhe të huaj, falë skrupulozitetit me të cilin u qaset burimeve, ka sjellë një narrativë interesante e cila ridimensionon shumë çka është shkruar mbi Shqipërinë e viteve ’50 në përgjithësi dhe Konferencën e Tiranës, në veçanti. Punimi gjithashtu ia ka arritur të ngacmojë ndjeshmërinë njerëzore, jo vetëm për fatin e delegatëve “rebelë” të konferencës, por nëpërkëmbjen e njeriut nën një regjim diktatorial. Si analiza e punimit, ashtu dhe korpusi me dokumente i përzgjedhur me kujdes dhe i pajisur me shënime dhe shpjegime të plota, ofrojnë një skaner mbi mekanizmat e “të fortëve” për të mbyllur gojë, për të shtypur individualitetin, për të depersonalizuar shoqërinë. Në këtë kontekst, “Pranvera e rrejshme e ‘56” është një punim mbi të shkuarën, por që i flet me zë të lartë dhe së sotmes.

**Prof. ass. dr. Sonila BOÇI**